



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 22024 Datë: **06.11.2024**

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr.13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 130 të mbajtur më datë 01.11.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I.** Akreditohet programi i studimit i Kolegjit UBT kampusi kryesor në Prishtinë, për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027):
 - *Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedisit MSc 120 ECTS, me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik;*
- II.** Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III.** Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor që deri më datë 15.11.2024 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV.** Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- V.** Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji UBT brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedisit MSc 120 ECTS (A)</i>	Armend Ymeri Sami Gashi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit AKA ka organizuar vizitat në Kolegjin UBT kampusi kryesor në Prishtinë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit: *Andreas Mehrle, Tauno Otto, Matej Drobnic*.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për këtë program të studimit; Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedisit MSc, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 19.06.2024, të cilën kanë konstatuar se nga shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht dy (2) ndërsa Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.

Fillimisht KShC pas shqyrtimit të raportit të ekspertëve dhe aplikacionit kishte nxjerrë vendim Ref.1711/24 datë 20.08.2024 me të cilin kishte refuzuar akreditimin e këtij programi me gjithë rekomandimin pozitiv nga ekipi i ekspertëve të jashtëm ndërkombëtarë, KShC kishte kërkuar sqarime shtesë për ndryshimet që ishin bërë në programin Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedisit MSc. Pas pranimit të sqarimeve shtesë nga Kolegji UBT, KShC ka konstatuar se ndryshimet që ishin bërë në Emërtim, kurrikula, lëndë si dhe në tërësinë e programit përfshijnë më tepër se 30 %, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi çdo ndryshim që përfshinë më tepër se 30% të programit konsiderohet Akreditim dhe jo Riakreditim. Bazuar në Paragrafin 3, nënparagrafin 3.6 të Nenit 37 të ligjit për AKA ku thuhet se, citojmë: "*Institucionet e arsimit të lartë obligohen të njoftojnë AKA-në me shkrim për çdo ndryshim të rëndësishëm, përfshirë: ... 3.6. ndryshimin e programit të studimit më shumë se tridhjetë përqind (30%).*"

Pas pranimit të vendimi të KShC-së Ref.1711/24 datë 20.08.2024, UBT brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave, i cili pas shqyrtimit të ankesës ka marr vendim që të aprovoj ankesën dhe i ka rekomanduar KShC-së që të korrigjoj vendimin me arsyetimin se Kolegji UBT gjatë plotësimit të aplikacionit kishte lëshuar gabim teknik në rubrikat e aplikimit, ku në vend që të shkruaj "A" (Akreditim) kishte shkruar "R" (Riakreditim). Pra gabimi ishte teknik dhe nuk kishte ndonjë problem tjetër përmbajtësor dhe rrjedhimisht nuk do të duhej të kishte ndonjë pengesë për akreditim të këtij programi.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 130-të, të mbajtur më datë 01.11.2024, ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit të ankesave dhe dokumentacionin e Kolegjit UBT, me ç'rast ka konstatuar gjendjen e njëjtë faktike dhe duke u bazuar në të dhëna e cekur më sipër, në bazë të kompetencave ligjore vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit UBT kampusi kryesor në Prishtinë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.